

Deklaratë privatësie për pasagjerët e Wizz Air që përjashtohen nga mbajtja e maskës gjatë fluturimit (në vijim "deklarata e privatësisë")

Kjo deklaratë privatësie përshkruan se si **Wizz Air Hungary Ltd.** (selia e regjistruar: Laurus Offices, Kóér street 2/A, Building B, H-1103, Budapest, Hungary), **Wizz Air UK Limited** (selia e regjistruar: Main Terminal Building, London Luton Airport, Luton, LU2 9LY, United Kingdom and **Wizz Air Abu Dhabi LLC**

(selia e regjistruar: Wizz Air Abu Dhabi, PO Box 145076, Abu Dhabi, United Arab Emirates) procesojnë të dhënat tuaja personale në lidhje me aktivitetin e procesimit të të dhënave të përshkruar në këtë deklaratë privatësie. Wizz Air Hungary Ltd., Wizz Air UK Limited dhe Wizz Air Abu Dhabi LLC, në vijim përmenden si Wizz Air, ku secili subjekt Wizz Air vepron si kontrollor i pavarur të dhënash. Kjo deklaratë privatësie vlen për pasagjerët e Wizz Air.

Lexojeni me kujdes këtë deklaratë privatësie dhe vini re se ajo thjesht përmbledh informacionin më të rëndësishëm rreth procesimit të të dhënave. Për informacion të mëtejshëm në lidhje me të dhënat tuaja dhe procesimin e të dhënave tuaja personale, shihni deklaratën e përgjithshme të privatësisë të përgatitur për pasagjerët e Wizz Air në faqen e internetit të Wizz Air (www.wizzair.com).

1. Përshkrimi i procesimit të të dhënave

Duke marrë parasysh nevojën e veçantë të disa prej klientëve tanë, Wizz Air ka hartuar procesin e mëposhtëm për t'i përjashtuar nga detyrimi i mbajtjes së maskës gjatë fluturimit.

Fillimisht, ju kërkohet të kontaktoni me qendrën telefonike të Wizz Air së paku 48 orë përpara fluturimit për të na njoftuar se po aplikoni për përjashtim nga mbajtja e maskës gjatë fluturimit tuaj me Wizz Air. Kjo na mundëson marrjen e masave për nevojën tuaj në aeroport. Është e rëndësishme që është e nevojshme të na njoftoni vetëm për faktin që kërkon trajtim të veçantë, pasi Wizz Air nuk kërkon ndonjë informacion për problemin tuaj shëndetësor, p.sh. diagnozën apo arsyen përse nuk mbani dot maskë. Nëse zgjidhni të ndani të dhëna të tilla personale me Wizz Air, ne do t'i procesojmë këto në bazë të pëlqimit tuaj me vullnet të lirë.

Përpara imbarkimit në avion duhet të paraqisni origjinalin e certifikatës suaj fizike mjekësore që konfirmon se nuk keni mundësi të mbani maskë për shkak të një problemi mjekësor, si dhe testin negativ PCR COVID-19, te personeli i Wizz Air në sportelin e checkin-it dhe në portën e imbarkimit, që të keni mundësinë të përjashtoheni nga mbajtja e maskës gjatë fluturimit tuaj me Wizz Air. Të dy dokumentet duhen lëshuar jo më shumë se 48 orë përpara nisjes së fluturimit tuaj dhe në gjuhën angleze. Wizz Air nuk mban dosje apo kopje të certifikatës suaj mjekësore apo të rezultateve të testit tuaj për COVID-19, por verifikon përmbajtjen e tyre duke e kontrolluar.

2. Çfarë llojesh të dhënash personale proceson Wizz Air për ju, për çfarë qëllimesh dhe mbi çfarë bazash ligjore?

Wizz Air proceson të dhënat tuaja personale për qëllimet e mëposhtme:

Qëllimi i procesimit të të dhënave	Llojet e të dhënave të procesuara personale	Baza ligjore e procesimit të të dhënave
Regjistrimin e kërkesës suaj për trajtim të veçantë	Emrin, numrin e telefonit, numrin e llogarisë së Wizz, të dhëna/informacion në lidhje me fluturimin, faktin se po kërkon përjashtim nga mbajtja e maskës, të dhëna të tjera, informacion ose fakte që keni ndarë me ne gjatë telefonatës	Zbatimin e kontratës së shërbimit (GDPR, neni 6 (1) b)) dhe pëlqimin tuaj për të dhënat personale të kategorisë së veçantë që ndani me ne

Regjistrimin e telefonatës suaj për t'u pajtuar me detyrimet ligjore të mbrojtjes së konsumatorit	Emrin, numrin e telefonit, numrin e llogarisë së Wizz, të dhëna/informacion në lidhje me fluturimin, faktin se po kërkonti përjashtim nga mbajtja e maskës, të dhëna të tjera, informacion ose fakte që	Detyrimi ligjor (GDPR, neni 6 (1) c))
	ndani me ne gjatë telefonatës, identifikuesin unik të regjistrimit të telefonatës	
Sigurohuni që përmbushni kriteret për t'u përjashtuar nga mbajtja e maskës gjatë fluturimit tuaj për shkak të problemit tuaj shëndetësor	Numrin e llogarisë së Wizz, të dhënat e identifikimit, të dhëna në lidhje me udhëtimin, faktin se pasagjeri ka kërkuar përjashtim nga mbajtja e maskës, të dhënat personale të përmbajtura në certifikatën mjekësore	Interesi legjitim i Wizz Air dhe i palëve të treta, konkretisht pasagjerët e tjerë që udhëtojnë me të njëjtin fluturim, për t'u siguruar që mbajtja e maskës nuk mund të bëhet nga subjekti i të dhënave (GDPR, neni 6 (1) f))
Siguroni shëndetin e pasagjerëve të tjerët dhe të personelit të Wizz Air	Të dhënat personale të përmbajtura në testin PCR	Interesi legjitim i Wizz Air dhe i palëve të treta, konkretisht pasagjerët e tjerë që udhëtojnë në të njëjtin fluturim, për t'u siguruar që pasagjeri që nuk mban maskë nuk është i infektuar me COVID-19 (GDPR, neni 6 (1) f))

Sipas përcaktimit të mësipërm është e nevojshme të procesohet kategoria juaj e veçantë e të dhënave personale nga Wizz Air, më konkretisht fakti se përmbushni kriteret për përjashtim, pasi nuk mund të mbani maskë për shkak të problemit tuaj shëndetësor, si dhe fakti se nuk jeni i infektuar me COVID-19. Testi negativ PCR është i nevojshëm për të garantuar shëndetin e pasagjerëve të tjerë dhe të personelit të Wizz Air.

Ky informacion do të kufizohet përpjesëtimisht dhe sipas domosdoshmërisë, duke marrë parasysh udhëzimin më të fundit të lëshuar nga qeveria hungareze, profesionistët e shëndetit dhe Autoriteti Kombëtar hungarez për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informacionit, për të menaxhuar dhe përmbajtur virusin.

Ne do ta ruajmë regjistrimin e telefonatës për 5 vjet pas regjistrimit në përputhje me ligjet për mbrojtjen e konsumatorit dhe do të ruajmë dosje të shërbimit që keni kërkuar për një periudhë prej gjashtë vitesh nga përmbushja e kontratës së lidhur me ne (d.m.th. fshirjen e llogarisë suaj të WIZZ).

3. Për sa kohë i procesojmë të dhënat tuaja personale?

Wizz Air nuk i mbledh apo ruan të dhënat tuaja personale, personeli i Wizz Air thjesht verifikon përmbajtjen e dokumenteve që u paraqiten.

4. Kush mund të ketë akses tek të dhënat tuaja personale?

Vetëm personeli i Wizz Air që verifikon përmbajtjen e dokumenteve ka akses tek të dhënat tuaja personale.

5. Me kë i ndajmë të dhënat tuaja personale?

Wizz Air nuk i ndan të dhënat tuaja me ndonjë palë të tretë.

6. Transferimet ndërkombëtare të të dhënave

Gjatë procesimit të të dhënave, Wizz Air nuk ua transferon të dhënat tuaja personale shteteve të treta jashtë Zonës Ekonomike Evropiane dhe/apo organizatave ndërkombëtare. Por, nëse fluturimet tuaja nisen nga një shtet që nuk është pjesë e Zonës Ekonomike Evropiane, procesimi i të dhënave tuaja personale do të kryhet në shtetin e nisjes, por duke marrë parasysh natyrën e procesimit të të dhënave tuaja personale, veçanërisht faktin se Wizz Air nuk jua regjistron të dhënat në lidhje me shëndetin, në këndvështrimin tonë aktiviteti i procesimit të të dhënave nuk përmban rrezik ndaj të drejtave dhe lirive tuaja.

7. Çfarë të drejtash keni në lidhje me procesimin e të dhënave?

Sipas ligjeve përkatëse për mbrojtjen e të dhënave, ju – në bazë të rrethanave konkrete – do të keni të drejtën:

- (i) për të kërkuar akses në të dhënat tuaja personale;
- (ii) **për të kundërshtuar procesimin e të dhënave tuaja personale.**

Mund t'i ushtroni të drejtat tuaja duke dërguar një email te përgjegjësi për mbrojtjen e të dhënave i Wizz Air ose mund ta dorëzoni kërkesën [KËTU](#) pasi të identifikoheni në llogarinë tuaj të Wizz te skeda e mbrojtjes së të dhënave. Nëse nuk keni llogari të Wizz mund të na kontaktoni duke e paraqitur kërkesën tuaj [KËTU](#).

Për qëllimet e përcaktuara në këtë deklaratë privatësie, Wizz Air nuk zbaton vendimmarrje mbi procesimin e automatizuar të të dhënave.

8. Për dëshmperblimet tuaja ligjore

Nëse mendoni se procesimi i të dhënave tuaja personale shkel dispozitat e ligjeve përkatëse për mbrojtjen e të dhënave, ju keni të drejtën të paraqisni ankesë pranë Autoritetit Kombëtar për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informacionit ("1051 Budapest, Falk Miksa 9-11."; telefon: +36 1 391 1400; email: ugyfelszolgalat@naih.hu).

Nëse autoriteti i mbrojtjes së të dhënave nuk ndërmerr veprim në lidhje me ankesën e paraqitur tuajën ose nuk ju informon brenda tre muajve për zhvillimet procedurale ligjore apo rezultatin e tyre, ose nëse mendoni se procesimi i të dhënave tuaja ju shkel të drejtat që gëzoni sipas GDPR, do të keni të drejtën të ngrini padi pranë gjykatës kompetente.

9. Informacion i mëtejshëm dhe përgjegjësi i mbrojtjes së të dhënave

Për informacion të mëtejshëm në lidhje me procesimin e të dhënave tuaja personale mund të kontaktoni përgjegjësin e mbrojtjes së të dhënave të Wizz Air te "Wizz Air Hungary Ltd., Laurus Offices, Kóér street 2/A, Building B, II-V., H-1103 Budapest, Hungary" ose te data.protection@wizzair.com.